MARS I PËRFLAKUR
Antologji poetike kushtuar dëshmorit Ismet Avdi Qorraj

Përgatiti : Flori Bruqi

MARS I PËRFLAKUR
Antologji poetike kushtuar dëshmorit Ismet Avdi Qorraj

Kjo Antologji poetike kushtuar dëshmorit të atdheut Ismet A. Qorraj përfshin gjithë poezitë që u paraqiten në konkursin e organizuar me këtë qëllim nga Axhensioni Floripres - Prishtinë, në pranverë 2015.

Vendin e pare në këtë konkurs e mori poezia Pranverë, e poetit Gentian Banaj. Vendin e dytë e mori poezia Balada për zogjtë e valsit diellor, e poetit Skënder Zogaj. Vendin e tretë e mori poezia Krenohemi me ju n'altarin Dardan, e poetit Engjëll Koliqi.

Poezitë botohen sipas alfabetit, përjashto tre poezitë fituese qe çelin librin.

Ky libër botohet në nderim të dëshmorit dhe në shenjë falenderimi për pjesëmarrësit në konkurs.

AXHENSIONI FLORIPRES PRISHTINË

Titulli : Mars Përflakur
Antologji poetike për dëshmorin Ismet Qorraj
Përgatiti dhe redaktoi : Flori Bruqi
Recenzent : Izet Duraku, Rexhep Shahu
Ballina & arti grafik : BoV Desing
Fotoja në ballinë : Deshmori Ismet Qorraj
© Të gjitha të drejtat janë të Axhensionit Floripres
ISBN: 978-9928-4261-8-5
Shtëpia botuese : Klubi i Poezisë, Tiranë
e-mail : klubipoezis@yahoo.com
Telefon : +355 682076965
+355682460417
Shtypshkronja : Vision Print Prishtinë

Prishtinë - Tiranë, 2015

MARS I PËRFLAKUR

Antologji poetike kushtuar dëshmorit
Ismet Avdi Qorraj

Përgatiti : Flori Bruqi

Prishtinë-Tiranë 2015

FLORI BRUQI

E SHKRUAN ME GJAK HISTORINË

Në historinë më të re të Kosovës përmenden, kujtohen (me të drejtë) ngjarjet e vitit 1968, 1981, 1997, 1998, 1999.

Por, tërësisht të lëna anash janë demonstratat e 28 marsit 1989.

Ata që harrojnë historinë, ajo mund tu përsëritet, thuhet jo rrallë.

Ka kohë, përkatësisht 26 vite që 28 marsi i vitit 1989 jo që po heshtet, por shumëkush (sidomos gjeneratat e reja) as që dinë se çka në fakt ka ndodhur në atë ditë.

Para lufte edhe pse institucionet nuk ishin si këto që kemi sot, kujtonin nëpër dhoma këtë datë

historike me takime të ndryshme e me vizita në familje të të rënëve dhe varret e të rënëve.

Ndoshta nga shumë njerëz kjo datë është e harruar dhe i takon vetëm të kaluarës , mirëpo nëse rikthehemi mbrapa do të shohim se kjo datë ka qenë ndër pikat kyqe të qëndresës shqiptare ndaj regjimit serbo-sllav , me protesta në mbrotje të shkollës shqipe, sovranitet të shtetit të Kosovës e deri tek çlirimi i saj.

Serbia pas protestave nëpër krejt ish Jugosllavinë "në mbrojtje të shtetësisë së saj" dhe jo rrallë edhe krijesës së Titos (Jugosllavisë), bëri çmos që të arrinte deri te suprimimi i Autonomisë së Kosovës. Ajo po ndihmohej edhe nga vasalët, që nëpër tubime thoshin se: "Kosova nuk humb asgjë, derisa Serbia barazohet me republikat tjera"! Për gjeneratat e reja që edhe s'mund t'i fajësojmë, po ua kujtoj se çfarë ndodhi në këtë ditë. Poashtu, edhe injorantëve të asaj kohe e që sot "harrojnë" këtë ngjarje me peshë po ua "freskoj" kujtesën. Serbia thoshte se po kthente elementët shtetëror, që kishte humbur me Kushtetutën e Kosovës të vitit 1974.

Tubimi kryesor u mbajt në Gazimestan, kur kasapi i Ballkanit Sllobodan Millosheviq kishte mbledhur rreth një milion serbë (në mesin e tyre edhe disa shqiptarë të ndershëm), duke u premtuar

se Serbia do t'u dalë zot serbëve e malazezëve në Kosovë.

Mbaheshin mbledhje që nga lagjet e deri më lart, ku haptas populli shqiptar dhe jo vetëm ai, kundërshtonte ndryshimet kushtetuese. Kujtojmë protestat gjithëpopullore të nëntorit 1988 dhe grevën e minatorëve në muajin shkurt 1989, që kundërshtuan paqësisht heqjen e elementit (shtetëror) konstituiv që pati Kosova, me Kushtetutën e vitit 1974.

Mirëpo, më 28 mars 1989 Serbia me tanke e dhunë bëri që Kosovës t'i merrej elementi konstituiv, me ndryshimet e dhunshme kushtetuese. Kosova, deri në këtë kohë ishte pjesë e barabartë e Federatës së atëhershme. Dhunshëm u ndërrua Kushtetuta e Kosovës.

Po të njëjtën ditë me 28 mars 1989 qytetarë të shumtë protestuan në shumë vendbanime të Kosovës.

Në Komunën e Prizrenit në mbrojtje të Kushtetutës ranë po atë ditë 5 dëshmorë (tre në Zhur e dy në Arbanë) dhe u plagosën dhjetëra të tjerë. Në Komunën e Deçanit u vranë katër demostrues (Ismet Qorraj, Agim Kukleci, Mujë Mehmetaj dhe Sali Hadërgjonaj).

Populli i Kosovës duarthatë dhe paqësisht kishte dalë në mbrojtje të Kushtetutës. Mirëpo, makineria serbe shkeli me dhunë gjithçka para

vetes. Vrau dhe shkatërroi gjithçka që i doli para. Protestuesit si në Deçan, Zhur e në Arbanë i vunë gjokset e njoma tankeve dhe blindave serbe që bashkë me njësitet speciale qëllonin pamëshirshëm mbi ta.

Në Beograd okupatori bashkë me kolaboracionistët e kohës pinin shlivovicë të Shumadisë, ndërsa në Kosovë derdhej gjak shqiptari.

Kundërshtimet sa vinin e rriteshin. Filloi dhe jeta e institucioneve të pavarura që organizuan mësimin, financat, kulturën e sportin, si mundësi e vetme e kundërshtimit e rezistencës aktive paqësore.

Kujtojmë edhe demonstratat e vitit 1990 dhe thirrjet për demokraci gjithandej nëpër Kosovë. Durimit po i vinte fundi. Shpërthimi i demonstratave të studentëve dhe mbështetja githëpopullore (1 tetor 1997) deri tek dalja publike e UÇK-së dhe operacionet luftarake, ishin veprime se po vinin ditë më të mira dhe se okupimit po i vinte fundi.

Mbështetja e aleatëve dhe lufta e heroike e djemve dhe vashave çliruan vendin tonë të okupuar nga hordhitë sllavo-çetnike serbe.

Pa dashur të minimizoj rëndësinë e gjithë këtyre ngjarjeve që kaloi populli ynë, do ta rikujtojë 28

marsin e përgjakshëm të 1989-tës ,do ta kujtojë me po aq pietet si gjithë datat tjera.

Jemi dëshmitarë të asaj që po duan të na ndërrojnë apo rishkruajnë historinë. Për të mos ndodhur një gjë e tillë, duhet që vetë ta shkruajmë atë. Të paktën këtë që e jetuam dhe disa nga ne jemi dëshmitarë të saj.

Shoqëria dhe institucionet duhet të jenë më koshientë, që në historinë më të re të Kosovës, t'i kushtojnë rëndësi të veçantë kësaj date.

Assesi nuk bënë të harrojmë gjakun dhe veprën e: Ismet Qorrajt, Agim Kuklecit, Sali Hadërgjonajt, Mujë Mehmetaj (nga Komuna e Deçanit) si dhe Muhamet Kabashit e Afrim Bytyqit nga Arbana, të Xhimshit, Xhylbehar e Hajrim Badallaj nga Zhuri dhe gjithë të rënëve tjerë në gjithë Kosovën në këtë ditë.

Derisa popujt tjerë nga balta bëjnë heronj, ne heronjtë po i bëjmë baltë!

GENTJAN BANAJ

PRANVERË

Nga kreshta e një mali, si shqipe drejt lirisë
Gjaku i Kosovës vërshon ndër dej
Pranverës së Ismetit vdekja i del pritë
Tokën amë plagos, si një lot ndë` qiej

Pranverë e përhumbur në logun tënd Deçan
I mbledh gjymtyrët prej dhimbjes gjer në palcë
Gjaku i rinisë vërshon si lumë dalështratit
Nga plumbat pashpirt që rendin turravrap

Nëpër asht të stinës bleron pikëllimi
E shpërthen bimëza të vogla loti
Pranverë e përgjunjur në tokë t`Deçanit
Me sytë drejt qiellit i luten zotit

S`mund të shkelë më livadheve rioshi Ismet
Me hapin prej dreri dhe prushin në sy
Shtatëqind vjet do vajtojnë tash kullat
Shtatëqind vjet Ajkunat do të mbajnë zi

Gaz e vaj do të vijnë e do të ikin stinët
Lugjeve do lodrojnë të tjerë Omerë
Lojë e tyre në kundërmim lirie
Moteve e brezave, t`ju sjellë pranverë

SKËNDER ZOGAJ

BALADA PËR ZOGJTË E VALSIT DIELLOR

Imja është piktura me sytë e përlotur
Edhe qielli ngjyrë ulliri sipër Deçanit
Plot zogj gjoks shpërthekuar,
Të zjarrtë dhe kryengritës
Si meteorë vezullues plot avaz
Që shpirtin e vet e bëjnë kurban
Se nuk e durojnë jetën në kafaz.

Zogj drite me flatra trëndafili
Përhapës magjik të valsit diellor

Ndër shtatë palë toke e qielli
me dashurinë hyjnore për Liri
Kundër ujqve të mallkuar e dinak
Gjithmonë të etur për gjak...

Në këngë është trimëria e zogjve
Prandaj gjithmonë vdesin duke kënduar
Si n'atë ag pranvere kur zaret u hodhën
Dhe n'pikturë u shprushën lulëkuqet
Që kurrë më t'mos kishte strehë për korba
As për këlyshë të zinj bushtre
Që i ulërijnë Hënës...

Nata ofshau zemërplasur nëpër konaqe
Por agimi u rilind me dritë zemre, o mik -
Shih zogjtë e valsit diellor që puthin qiellin
Në Carrabreg, në Voksh e në Maznikë...

ENGJËLL KOLIQI

KRENOHEMI ME JU N'ALTARIN DARDAN

Duke dëgjuar kushtrimin
Nga Gjergji i Madh i Kastriotëve
Nga Mic Sokoli e Hasan Prishtina
Nga Bajram Curri e Idriz Seferi
Vrapuat mbas Nënëlokes Dardani
Ta merrni në mbrojtje e ta shpëtoni

O i dashuri ynë
Ismet Avdi Qorraj
Ti djaloshi i Dardanisë
Ishe i Madh
Dhe nuk e duroje më gjakatarin
Të lodrojë e të shkarkojë në trojet tona
Jo

Kur e pe
Se shkjau u tërbua
Ti Ismet i dashur
U ngrite në këmbë

Në mbrojtje të Kushtetutës Dardane
Në Deçanin heroik
Bashkë me Selimin, Mujën e Agimin
Ratë nën plumbat bum-bum
Të shkijeve fashisto-komunistë

Jetën tokësore e mbyllët
O dëshmorët e kombit tonë
Por nuk keni vdekur
Jo
Dhjetë vite mbas
Nënëlokja Kosovë
U çlirua nga kriminelët serbianë
Amaneti juaj shkoi në vend
Gjaku juaj ujiti lule lirie e dashurie

Ne kemi qarë shumë
Për ju
Sot krenarë
Kremtojmë
E këndojmë
Me mburrje
Që ju patëm të tillë

Lavdi ju këndojmë
N'altarin dardan
Sot e përgjithmonë

PROF. DR. BEGZAD BALIU

ISMET AVDI QORRAJ

Në biografinë e një dëshmori zakonisht identifikohet një datë, një vit apo një ngjarje e caktuar me të cilën ai ka fituar përjetësinë. Të tjera momente dhe ngjarje, janë ato që i dallojnë biografitë e tyre dhe me të cilat krijuesit nxiten të shkruajnë biografitë e tyre apo frymëzohen të shkruajnë tekste të gjinive dhe llojeve të ndryshme letrare për ta.

Ismet Avdi Qorraj është njëri prej atyre dëshmorëve, në jetën e të cilit nuk është vështirë të identifikosh edhe disa shenja përcaktuese për biografinë e tij prej dëshmori. Ismet Qorraj u lind në fshatin Carrabreg të Ulët të Deçanit, më 21.01.1968, në një familje të varfër, por me traditë atdhetare. Viti i lindjes së tij (1968), më parë se sa kujtesën për ndryshimet politike që ishin shfaqur

në Kosovë, në familjen e tij kujtohej për vrragët që kishte lënë një periudhë e gjatë e sundimit rankoviqist, ndërsa shumë prej tyre i kishte realizuar nën hijen e miteve sakrale dhe politike të lidhura ngushtë me emrin e mitit të Stefan Dushanit, të ringjallur gjatë shekullit XX në emrin e qytetit të tij, Deçanit dhe të institucioneve fetare të ruajtura rreth tij.

Pasi mbaroi shkollën fillore dhe të mesme në Deçan, Ismeti i vazhdoi studimet në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Gjakovë, në degën Gjuhë dhe letërsi shqipe. Ismeti po rritej në frymën e një rizgjimi kombëtar, në të cilën gjuha shqipe e rilindur pas Konsultës Gjuhësore të Prishtinës (1968) dhe hyrjes së literaturës shqipe nga Tirana shfaqej në plan të parë. Veprat e karakterit letrar dhe historik njëkohësisht Ismet Qorrajn e mbanin të lidhur me zhvillimet historike dhe aktuale të popullit të tij. Temat e mëdha të karakterit nacional që sillnin botimet nga Tirana, si ato për Mic Sokolin, Bajram Currin, Isa Boletinin, Rilindjen Kombëtare, të cilat Ismeti i lexonte me dashuri dhe i komentonte mes shokësh, nxiteshin edhe prej kujtimeve familjare, madje të prejardhjes së babait dhe nënës së tij. Kujtimet ishin nga më tragjiket. Ato të trashëguara nga babai në Deçan dhe ato të treguara nga nëna e lindur në krahinën epike të Rugovës. Në netët e gjata të dimrit dhe në odën e

familjes sa e sa herë kishte dëgjuar kallëzimin e babait Avdi Qorrajt, se si mezi i kishte shpëtuar masakrës në Tivar, më 1945 dhe për më tej kishte mësuar nga pleqtë e familjes së gjerë, se si çetnikët e Savë Batarës kishin masakruar më 1912 tërë fshatin Carrabreg, në mesin e të cilëve kujtimet në oda dhe epizmi në këngët historike flisnin gjallërisht për vrasjen e Osë Qorrajt, sepse kishte bërë rezistencë legjendare "për të mos e ndërruar kombin dhe fenë". Edhe kujtimet e nënës Zade, bijë e familjes së Xhemë Sadrisë nga fshati Malaj i Rugovës, nuk i mungonin. Prej tregimeve të heshtura të saj kishte mësuar se si çetnikët e kishin masakruar fshatin dhe tërë familjen e Xhemë Sadrisë. I kishte dëgjuar kujtimet e saj mes legjendash dhe dhimbjesh të pafundme për breza të tërë familjarësh të djegur e të vrarë ndër stinë e mote të trishta. Një shekull i tërë kolonizimesh të fshatrave, përndjekjesh të bashkëfshatarëve dhe jetës nën hijen e xhandarëve. Të gjitha këto ngjarje tragjike të lidhura me ngulfatjen që kishte pllakosur Kosovën nga viti 1981 e këtej, tanimë e kishin bindur Ismetin se, pa liri nuk ka kuptim as jeta. Kishte dhjetë vjet që Kosova ishte kthyer në një gjykatore të madhe dhe në një burg të zi. Për një të ri si Ismeti që kishte më shumë ëndrra se sa vite jete, Kosova ishte një dramë e madhe, jashtë të cilës nuk mund të qëndronte as ai. Përkundrazi, me

vrullin djaloshar që i vlonte në shpirt e në zemër, ai jo vetëm nuk mund të merrte rolin e arrivistit, sikur shprehej bashkëfshatari i tij Jusuf Gërvalla, a të indiferentit, por pretendonte të merrte një rol të fuqishëm për të lëvizur përpara zhvillimet kombëtare, e ky rol para se gjithash projektohej në rolet e identifikuara të bardëve kryengritës të kombit, në rolet e identifikuara nga kallëzimet e babait dhe të nënës. Në mars të vitit 1989 kishte nisur së shpërthyeri një revoltë popullore, si një vullkan i zjarrtë, i cili e kishte burimin në 700-800-900 metra thellësi të minierës së Trepçës, ku minatorët vetëm një muaj më parë bënë grevën e urisë për tetë ditë me radhë dhe ishin të gatshëm të sakrifikonin edhe jetën, për ta bindur botën se Kosova është e robëruar dhe robërinë s'do ta durojë më. Ishte viti i kryqëzimeve dhe i përplasjeve të mëdha, që tejkalonin përmasat e Kosovës, por që më parë se sa në hapësirën jugosllave përpiqeshin të shpërthejnë në duart e shqiptarëve. Ishte viti kur serbët përpiqeshin të rikthejnë një gjendje të tejkaluar në fund të viteve '60, kur shqiptarët përpiqeshin të sendërtojnë ëndrrat e tyre historike të lara me gjak në vitin 1981, ndërsa mes tyre republikat veriore përpiqeshin të çliroheshin nga etnocentrizimi dhe etnofashizimi serb, duke ia lidhur duart asaj me Kosovën. Me 28 mars 1989 Serbia po shënonte festueshëm ndonës me tanka

dhe me gjak e hekur ditën e aprovimit të kushtetutës ushtarako- policore, me të cilën edhe de jure suprimohej çdo element i Autonomisë së Kosovës, kurse tërë Kosova ishte bërë barrikadë në përleshje fyta-fyt me xhelatët serbo-çetnikë, për t'ju treguar atyre që ëndrrën për Perandorinë e Car Dushanit e kanë të kotë. Për katër orë rresht populli i gozhdoi radhët e policisë duke u barikaduar në kundërshtim të vendimeve të tilla, të cilat edhe njëherë Kosovën po e kthenin nën hijen e xhandarit serb. Kishin dalë në rrugë të gjithë, të rinj e të moshuar, burra e gra, shkollarë e punëtorë, bujq e intelektualë, pa përjashtim dhe si një. Me vendosmëri e brohoritje sikur përpiqeshin të gjithë, por në kundërshtimin e të ndërhyrjeve ushtarako-policore dalloheshin më të rinjtë. Pas disa orësh, forcave policore serbe ju erdhën përforcime të reja, të cilat hapen zjarr mbi popullin e paarmatosur. Mes popullit, por gjithnjë në radhët e para gjendej edhe Ismeti dhe kolegët e tij kryesisht i së njëjtës moshë. Plumbat e shkrepur nga policia e goditën Ismetin për vdekje, por ai nuk kthehej prapa. Fjalët e tij të fundit drejtuar shokëve ishin: Përpara shokë, se shqiptari nuk tërhiqet përpara plumbave të armikut! Ja vdekje - ja liri! Pikërisht si në veprat letrare e historike, të cilat i kishte lexuar në bankat e Gjimnazit dhe në Shkollën e Lartë Pedagogjike, Ismeti dhe kolegët e tij u hodhën përpara si në

betejë, ndonëse plumbat përshkonin trupat e tyre të njomë. Ishte ora 15 e 30 minuta. Rrugët e Deçanit u lanë me gjakun e popullit shqiptar të kësaj ane. Qyteti i zgjuar me vrullin e popullit duarthatë, po ngrysej ende pa rënë mirë muzgu i mbrëmjes, më parë se çdo ditë tjetër. Vullneti i një populli të tërë po shtypej me tanke, me plumba e me zjarr. Rrugët e tij, sheshet e tij ishin larë me gjakun e martirëve të lirisë: Agim Kuklecit, Salih Hadërgjonajt, Mujë Mehmetajt dhe Ismet Qorrajt. Në varrimin e Ismet Qorrajt, në ndarjen e fundit nga martiri i lirisë, populli u betua me besa-besë si në kohët e lavdishme të Lëvizjes së Madhe të tij, si në kohën e Haxhi Zekës, se gjaku i martirëve do të shpaguhet ditën e çlirimit të Kosovës. Babai Avdiu, nënë Zadja me të nëntë fëmijë (katër djemtë dhe pesë vajzat), bashkë me popullin mbaheshin krenar që Ismetin ia falën Kosovës. Por, Ismeti nuk ishte vetëm asnjëherë. Trimi i mirë,- thoshin shkrimtarët që ai i kishte shumë përzemër, - me shokë shumë! I tillë ishte Ismeti. As vdekjen dhe martirizimin nuk e dëshironte vetëm! As lavdinë, vetëm për vete!
Prishtinë, mars 1995
(Ismet Qorraj ne vëllimin: Avdi Gjata, Resul Bedo, Bajram Kurti, Begzad Baliu:"GJAKU I LIRISË 1981-1995 (I), KMDLNJ, Prishtinë, 1996, f. 65-66).

QAZIM BERISHA

STUDENTI EMBLEMATIK QE E DESHI LIRINË MË SHUMË SE JETËN

(Me rastin e 26 – vjetorit të rënies heroike të Ismet Qorraj dhe martirëve tjerë...)

Kësaj toke martire kurrë nuk i kanë munguar burrat, kurrë nuk i kanë munguar bijtë dhe bijat për t'i dal zot atdheut, i tillë ishte studenti qe kishte bukurinë e rrezeve të diellit, njëzet e një vjeçari Ismet Qorraj nga Carrabregu i Ulët i Deçanit.

Ismet Qorraj u lind me 21 janar 1968 ne fshatin e martirizuar Carrabreg të Deçanit. Shkollën fillore e kreu në Carrabreg ndërsa të mesmen e kreu ne gjimnazin "Vëllëzërit Frashëri" në Deçan. Studioi në Shkollën e Lartë Pedagogjike, Dega: Gjuhë dhe Letërsi Shqipe në Gjakovë.

Babë Avdiu dhe nënë Zadja kishin lindur dhe rritur dhjetë fëmijë (pesë djemë : Xunin, Smajlin, Muhametin, Xhevdetin dhe Ismetin dhe pesë vajza: Ajmanin, Ajshën, Kumrinë, Ganimetin dhe

Valbonën), të gatshëm kurdoherë për të sakrifikuar për lirinë e atdheut.

Ishte pranvera e marsit 1989, kur qiellin e Kosovës e kishin mbuluar re të zeza si kumt për një plojë gjaku për të hapur varre e për të lëshuar gjëmë të madhe.

Më 23 mars 1989, pas një mbledhje të gjatë në Kuvendin e Kosovës, i cili ishte vënë në rrethim të hekurt nga forca të shumta policore, u suprimua Autonomia e Kosovës.

Kushtetuta pesëmbëdhjetë vjeçare (1974-1989) më 23 mars 1989, ndërroi jetë, sepse ishte ngulfatur nga Sebia fashiste dhe ishte shkelur me tanke duke u varrosur para syve të botës.

Kjo vdekje e dhunshme e Kushtetutës së Kosovës nuk kishte prekur fare ndërgjegjjen e Republikave jugosllave, duke mos menduar se kryetari i Jugosllavisë Sllobodan Millosheviq po fillon me Kosovën për të vazhduar me Republikat tjera.

Populli i Kosovës nuk kishte çka të humbas më shumë përveç prangave të robërisë, u ngritë në këmbë i madh e i vogël, nuk heshti, por ngriti zërin dhe u hodh në demonstratat e fuqishme në tërë Kosovën.

Ishte 27-28 Marsi 1989, ku sheshet e Kosovës po lahen me vrushkuj gjaku të bijëve dhe të bijave më të mirë të popullit.

Në Prishtinë bien edhe martirët e parë dhe gjithë andej Kosovës.

Në Deçan bie studenti i dalluar Ismet Qorraj, sypetriti qe nuk di cka është frika.

Babë Avdiu dhe nënë Zadja kur moren kumtin nuk derdhen lot, as motrat nuk morën kujen, as vëllezërit nuk u ligështuan.

E tërë familja dhembjen e madhe e kishin shndërruar në forcë.

Ismeti nuk ishte vetëm , përkrah tij ishin edhe shoket e idealit që ranë në altarin e lirisë, Salih Hadërgjonaj, 19 vjeçar nga Vokshi i Deçanit, Agim Kukleci, 31 vjeçar nga Isniqi dhe Mujë Mehmetaj, 36 vjeçar nga Mazniku i Deçanit.

Më 27-28 Mars 1989, toka e Kosovës po i shtërgon në damart e vet më shumë se 25 martirë që ranë për mos të vdekur kurrë.

Për të mos u mbetur borxh këtyre martirëve po i radhisim ashtu siç ranë në altarin e lirisë:

Prishtinë: Ismet Krasniqi nga Grashtica e Prishtinës, Sevdat Berisha (Xhafolli) nga Drenoci i Prishtinës, Shukrie Obertinca nga Lismiri i Fushë Kosovës, Vetim Shala nga Nasheci i Prizrenit dhe Mustafë Veselaj nga Reçani i Therandës.

Mitrovicë: Bedri Hasani nga Mitrovica, Ramadan Zeqiri nga Kopiliqi i Epërm i Skenderajt, Hakif Bislimi nga Koshtova e Mitrovicës, Behram

Sumiqi nga Reshani i Mitrovicës dhe Hilmi Kajtazi nga Vitaku i Skenderajt.

Besianë: Mehmet Ejupi nga Sekiraça e Besianës dhe polici shqiptar Jetullah Kuçi nga Theranda, për të cilin Serbia u mundua t'i fajsojë demonstruesit llapjan, duke e fshehur dorën e vet vrastare.

Prizren: Xhemshit Badallaj, Gjylbehar Badallaj dhe Hajrim Badaj që vetëm 11 pranvera i kishte shijuar, të gjithë nga Zhuri i Prizrenit, si dhe Muharrem Kabashi dhe Afrim Bytyqi nga Arbana e Prizrenit.

Malishevë: Plumbave gjakatarë nuk u shpetuan as fëmijët 11 vjeçarë Din e Arsim Paçarizi nga Dragobili i Malishevës.

Gjilan: Agim Rashiti nga Draganci i Gjilanit.

Atë ditë kur në Kosovë po lahej gjaku me autobote nëpër sheshe dhe rrugë të Kosovës dhe po hapeshin varre gjithë andej Kosovës për t'i varrosur martirët e lirisë, Serbia gjakatare po festonte dhe po i cakërronte gotat në shenjë fitoreje që varrosi Kushtetutën e Kosovës. Por jo edhe gjatë më shumë se dhjetë vite. Sepse Lufta jonë Çlirimtare e UÇK-së përgjithmonë largoi shputat karpatjane nga toka jonë shqiptare.

Lavdi e përjetshme gjithë brezave ndërshekuj që derdhën gjakun për lirinë e Kosovës, për ketë liri qe po e gëzojmë ne sot. LAVDI!

AISHE QORRAJ

LULËKUQET E MARSIT

Për Ty është nder të shkruaj,
Dy shkronja në shenjë kujtimi,
E vlerësuar ishte koha,
Trimi dallohej pikërisht aty.

Marsi na sjell dhembje,
Lirinë e njomur me gjak na kujton,
Duhet ta pyesim veten,
A ju dalim hakut ne që tani po e gëzojmë,
Juve që me gjak e shtruat rrugën,
Lulëkuqe të marsit.

A të kujtojmë rininë tuaj,
A t'i vajtojmë plagët e trupit,
A të krenohem me vigjilencën tuaj
Për Ty meteor i pashuar
Lavdia e kombit jeni ju vet,
Martir – hero pusho i qetë,
Pluhuri i harresës mbi varrin tënd kurrë nuk do të bjerë.

AGIM H. BERISHA

BUZËQESHJE YLBERI

Malet kurrizdalë
Dhe me zjarrmi
Malet kishin plagë
Ç'dridhej
Shekulli hijerëndë
Nga zëri i lirisë
Ti
Shkëmb Dukagjini
Lulebozhure
Edhe një gjekëtimë
E Bjeshkëve të Nëmuna

Ti
Etje
Në buzët e stinëve
Kujtesë
Buzëqeshje ylberi
Në sytë tanë

AGIM DESKU

NË CILIN VARG MBETEM FLAKË DIELLI

Se do më çmendë kjo krismë djallësh
Nuk di të zë kohën që më ikën si marramendje
Tokës i vjen erë mëkatësh si dje dhe sot.

Askush nuk më flet sikur jam i vërbër
Më denojnë kujtimet që kurrë nuk i harrova
Dhe sa herë flas me zotin tim kam ledhatime
engjëjsh.

Këtu dëgjoj këngë trupi të dhembjeve mijëvjeçare
Shfletoj historinë dhe askush nuk di udhën e
bashkimit
Dje më vranë mëkatin që e shava botën e flliqur
Së ma ndyti shpirtin dhe emrit mi bëri gjyq Hage.

Nuk kam menduar kurr të jem e vetmja fytyrë engjëlli
Bota deshti të çmendet nga bukuria e shqipve të gjakut tim.

Ah, edhe djajt kanë fillue kacafytjen dhemb për dhemb me mua
Çfarë faji kam pse linda njeri në dheun tim pellazg
Pse vargu im ngrihet dhe mbetet flakë dielli për liri.

Sonte jam me fat se më thyhen gotat copë e grimë
Dhe mëkatet e jetës nuk rrijnë asnjë ditë me mua
Ku të marr edhe një buzëqeshje hëne
Të ngrihem dhe të ngre dolli për varg ylli.

Sonte lidha bast të të shkruaj vetëm një varg poeti
Të kujtoj Purgatorin, eh, besa edhe Ferrin e Dantes
Dhe në hyjni vet u shndërrova bashkë me vargun tim
Të dy u bëmë për ty flakë dielli.

BILALL MALIQI

ÇDO MARS

Çdo mars sikur i dëgjoj thirrjet
Për liri e drejtësi

Ato lanë gjurmë edhe në ëndërr
Sa për t'i parë fytyrat engjëllore

Aty ishte edhe Ismeti
Zëthirrës m'u në mes të heshtjes

Ato zëra u shkrinë në këngë
E më vonë në pentagram lirie

Çdo mars e lexoj kushtrimin
Nëpër faqe të shkruara për trimin

DRENUSHA MORINA

ISMET QORRAJ - PISHTAR I LIRISË

Në shi e furtunë heroikisht qëndrove
Ti mbolle farat e pavarësisë
Breshëri plumbash i patundur i përballove
Trim, Ismet Qorraj - pishtar i lirisë!
Në demostratat në Deçan më 28 mars 1989
Luftove kundër armikut si luan
E mbrojte nderin e vendin tënd!
Mallkuar qofshin ujqërit e zi
Që mizorisht ta morën jetën
Se ti dhe jetën për ideal dhe liri
Të vranë se e thoje të vërtetën.
Më 17 shkurt u arrit ajo që ti synove
Prandaj prehu i qetë në amshim
Ti luftove për liri e lirinë s'e shijove
Bekuar qoftë gjaku yt o trim!
Që 26 vite tretur nën dheun e zi
Por kujtimi për ty është i përjetshëm,
Më i gjallë se kurrë je në histori
Trim mbi trima, i pavdekshëm!

DIBRAN FYLLI

SHTIGJEVE TË LIRISË

...ditë marsi
tinguj lirie dëgjoheshin,
mjegulla mbuloi qiellin blu
shi e plumba u bënë jehonë
e shpërndaheshin gjithandej shqiptarisë.
Ai
thuri hartën e atdheut,
rininë e tij
madhërishëm
e mbylli në shtigjet e lirisë...

ERMELINDA SMAJL QORRAJ

PARA VITEVE TË LIGA

Zërin e kishe të ëmbël
Syrin e mprehtë
Vështrimin e thellë
Mendimin e qartë
Urdhërin e prerë
Fjalën e zjarrtë

Postieri
Rilindjen
E asaj dite të kobshme
Na solli

Si një copë drite
Nëpër të çarën e derës
E futi
Dhe në të
Ismeti... vdiç në logun
e burrërisë

Kalorës i nxirosur
Hiçi i madh
Të erdhi vërdallë
Para vitëve të liga
të shekullit
që pinte gjak
Përtypte barot
Fashatonte plagën
e Ti
Ismet
u dole para
Agimeve marsjane
kur trolli me nofullat e veta
Kafshonte bijtë e tij.

ESAT LOSHAJ

RREZE DIELL

Tokë Kosova djep që t'rriti
të ushqej me dashuri
për t'luftuar si shkabë mali
O flamur në lartësi
Legjendë gjallë trim me fletë
Carrabregas luleborë
yll i ndritur shtatëlartë
ishe mbret me kurorë
Pavdeksinë e firmose
me thurime këngë epike
hallall gjiri i nënëlokës

jo për nam as për karrigë
Kënga pak është për Ty
Hero yni kapedan
T'i ke hyrë në histori
ne zemër të popullit vigan
je simbol i dritë henës
gjak pastër diellor
luftëtari i lirisë
trim hero - madhështor!....

ERMIRA R. ISUFI

PUSHKA TUNDI MALET

Kushtrimi për liri
Jehoi në këto troje,
Veç trimat e paepur
Ia mësuan hilet kësaj loje.

Këmba e pushtuesit
Ndrydhte çdo shpresë,
E rëndë ishte jeta
Me këta të pabesë.

Duhej dalur zot
Trojeve të të parëve,
Kujt i bie kjo detyrë,
Përveç çlirimtarëve?

Nuk ishte kohë durimi,
Shpresat na mbyteshin çdo ditë,
E liga e këtij shekulli
Gjithkah kishte zënë pusitë.

Pushka e trimave të atdheut,
Fuqishëm tundi malet
Dhe botës iu bë e ditur,
Se rruga lirisë dot s'ndalet!

Ajo pushkë çlirimtare,
Përgjithmonë shembi robërinë,
Që brezat nëpër shekuj,
Ta gëzojnë lirinë!

FJOLLA QORRAJ

RRJEDHAT E KOSOVËS

Mars
Viti '89
Flinin në një dhomë
10 fëmijë
si në një zemër
mbi katër shtrate
të mbulur me jorgan
E kishin mall shtojën
nga tranditja e hapave
të policëve serb
mbi kalldrëm....

Babi im Xhevdeti
kujton të kaluarën

plagët e vjetra
vrasjen e vëllait të tij të vogël-Ismetit
nga serbët
copat e misrit
Flamurët....

****

Kanë kaluar shumë vjet
Zemra kapton malet
dhe e ndjej veten
të lirë
të re
të fortë
ashtu si Dielli që nxe'
Tokën pranverore
të lirisë.

*****

Xhaxhi Ismet
Flamur i fronteve
Ylber i horizonteve
ti ishe i zoti
e durove etjen...

Ismet
furtunë e fllad i zemërçarës
shndërrim i buzës së beharit
Ti çel si lule

shpërthen si rrëmet
mëkon plagët e Nënlokës-Zade
në mes kaq këngësh
në mes kaq dhembjesh
si lumi
si era si gjaku
Liria shpërtheu te praku
me besë e shpresë

të ndjej në shpirt
se unë mbesa jote
borxh ta kam
me krahërorët masivë
në rreshtat e mëdhenj
të detit tekanjoz...

FLORI BRUQI

BALADA E YJVE

(Të rënëve : IsmetQorraj, Agim Kukleci, Mujë Mehmetaj dhe Sali Hadërgjonaj)

A qan sot Deçani
A dënes Kosova
A përloten fëmijët
A shkrehen në vaj
Ato Bjeshkët e Nemuna
Për vdekjen e tyre
Si ta zotëroj veten

Kosovë
Ti ke rrënjet te Sumerët
Ti ke këngën
Në trollin gjakndezur
Se ky Dhe
Në çdo thërrime
Ka gjakun e dëshmorëve
Udhëtarë
Që sot a nesër
Kaloni
Pranë Lapidarëve të dëshmorëve
Një përshëndetje ju lutem
Në kalim
Se këtu...

Katër dëshmorë i zuri gjumi
Nga drapër i Sinagogës

FRAN UKCAMA

SHQIPONJAT E MARSIT KU E KANË FOLENË

Kombi mbi krahnuar ka varë medaljonet,
Shekujsh janë shkruar me flakë e me gjak,
Sot po shungullojnë e nuk prajnë heronjtë,
Ata kanë folenë mbi flamur kombëtar..

Marsi i egërsuar, erdhi me duhamë,
Lulet pse nuk dolën, pse prani bilbili,
28 dita, motit 1989,
Kosova në kambë, për liri shpirti !

Shpirti i lirisë, Kosova vullkan,
N`ball të armikut, me zjarr e me hekur,
Kala u banë zemrat, kushtrim mbi Deçan,
Trimat shkruan legjënda, trëndafila të qeshur.

Yjet u ngritën në cikole qiellit,
Heronjtë qëndruan nuk e njohën frikën,
Me shqiponja ngjitun n`qerpik të diellit,
Nderin e Kombit, oh sa lart ngritën..

Ismet Qorraj i pari, me duhi dragoni,
Trimat përbetuar si luaj rreth tij,
Agim Kukleci, Sali Hadërgjonaj,
Mujë Mehmetaj, qe, kreshniku i ri..

Trimat e Deçanit simbole atdhetari
Za i lshuan vatanit, kushtrim për qëndresë,
Afrim Bytyçi e Muhamet Kabashi,
Arbanës, të lindur , lidhun besa me besë!

Si dallgët e Drinit, ardhur mbas furtunës,
U lshuan armikut dy burra të Zhurit,
Xhylbehar, Hajri, Xhymshit Badallaj , fisi i pushkës
Nana i pat lindur, shqiponja maje gurit..

Kthehu Kosovë udhënajës, në kujtesës historike,
Pa mblidhi shqiponjat n`fushë, kodër e mal,
Trimat që vunë shpirtin në Piedestal lavdie,
Qielli i mban në krye, Kombi n` sy i ka !!
Po e lypi liria , liria kur ka grahmë,
Kosova e Shqipëria po t` qesin kushtrim,
Heronjtë e Marsit prapë ngrihen në kambë,
Vorri i tyre asht, asht te shpirti ynë !

FARIDA RAMADANI (ZMIJANI)

TESTAMENT I PAVDEKËSISË

Katër shkronja çdo shqiptar,
Në AND skalitur me kujdes.
L-I-R-I bëlbëzon foshnja,
Që në bark të nënës përmendur.
Ismet Qorraj mori librin,
Sytë e ndezura si diell,
Ku dhimbja grushtin përgjak,
Me flamurin ngjyrë zjarri,
Gllabëroi skenën e jetës,
Si triumf krenarie.
Pavarësia,
Përhapte ngjyrë shenjtërimi,
Në dejet e Ismet trimit,
Në flakën e urrejtjes,
Mes plumbash si furtunë.
Ismet Qorraj pishtari nga Deçani,

Si luanë në fushbetejë,
Kundër armikut gjakatarë,
Armëngjeshur të rinjtë janë,
Saliu, Agimi e Muja fuqi baroti,
Në logun e betejës si orteqe loti triumfi,
Serbo-malazezi më dysh qiellin ndau,
Brishtësinë djemve ua rrëmbeu,
Ëndrrën në mes ua ndërpreu,
Bedenat e gurta të dritës,
Errësuan rininë e djelmoshave.
Por ato si mburojë morën idealin,
Stafetë brezash e bënë,
Qiejt e shqiptarisë dhanë bekimin,
Shi petalesh tek pllaka e varrit,
Ku harresa nuk mund ti vrasë.
Për Ismetin u flas njëzet e një trëndafilëve,
T'a thonë ëndrrën e tij të bukur,
Zambakët të ruajnë amanetin,
Rapsodët të thurin këngë si ninullë,
Drurët të gjethërojnë pranverën,
Tulipanët të gjallërojnë jetë.
Dëshmorë si ty Ismet Qorraj,
Toka nuk mund ti tretë.
Si një medaljon shqiptarie,
Testament i pavdekësisë do të mbesë.

FERA KRASNIQI

DO TË ISHA BËRË NUSE NË CARRABREG...

Kur isha në gjimnaz
një shoqe e klasës
e XI-ta 4
Tha
po të ishte gjallë Ismet Qorraj
do të isha bërë nuse në Çarrabreg
ja kisha puthë unazën çdo ditë
si Xhulieta-Romeut
ka qenë i bukur si mali
ka qenë i bukur si deti
dasmën e kisha bërë në Prizren
ishim fotografuar tek Shtëpia e Lidhjes
dy djem dhe dy vajza ja kisha rritë
në zemër
dritë i kishin bërë Ilirisë.

GANI XHAFOLLI

NË SHPIRTIN TIM ENDE LOTON LOTI

Motra e tij më tha një ditë me bore
Kur u vra vëllau im Ismeti
Zemrën time e mbuloi loti...
Pranverë pa lule ishte marsi
Nënëlokja ja puthi plagën
Babë Avdiu ja puthi dorën
Në Carrabreg
Pesë motrat ja puthën Flamurin
Mbi fytyrë
Nipi, në një copë Guri e nisi poemën
Ismeti shumë e donte Lirinë
Shpeshëherë ka pije ujë
Në Malajt të Rugovës
Tek kroni i Xhemë Sadrisë
E donte një vajzë nga Kosova
Të bukur si Hana...
***
Nana Zade deri në vdekje të saj
Ja ruante unazën
Me shqiponjë
Kur u vra ishte 21 vjeç
Mbi Deçan kishte shumë sorra të zeza dhe
Korba.

II
Një natë motra e Madhe u tha
Yjeve
Ismeti shumë e donte Shqipërinë
Dhe Krujen e Gjergjit
Shumë e urrente Kalin e Trojës
Shumë e donte Toplicën dhe Mollën e Kuqe
Në njerën veshkë i ridhte Drini i Bardhë
E në zemër kishte edhe Drinin e Zi
Hëna çdo natë ja puth Përmendoren
Që bëjnë dritë dhe Lulet
Loti i Nanës e shpon edhe Gurin
I thane edhe pemët
Nga Përmendorja e tij u shfaq
Një Dritë
Të nesërmen një ylber
Mbi Përmendore Dielli mori ma shumë bukuri
III
Me 28 mars ’89 të gjitha Pishat ishin
Të lagura në Deçan
Me 27 mars ’89 u vra Sevdat Berisha në Prishtinë
Shumë copa Dielli ju këputën Ilirisë
Shumë nana dëshmoresh i lagu loti i mërzisë
IV
Ismeti kur e përqafojë Nanë Zadën
Tha si Jusuf Gërvalla:
Nanë nuk ta due LOTIN
Edhe nëse vritem

Përqafoje një pemë në oborr
Në vend meje
Unë pa Diell nuk kthehem
Atdheut i duhet pushka
Jusuf Gërvalla u vra
Ismeti, Agimi, Salihu, Muja u vranë...

V
Thashë kur isha në Carrabreg
Ismeti u bë pemë
Mbi degë pushon Dielli
Nuk di a ka diçka ma bukur
Lum Nana që ja fali Djalin Lirisë
I thashë Bjeshkëve të Çarrabregut
Një Yll duhet ta ketë emrin Ismet
E Dielli emrin Adem
E Hëna emrin Marigonë
Atdheu mori bukuri edhe nga gjaku
Shumë Lule dhe shumë pemë ka Dardania
Motra K. e rritë një Lule Dritë
Në Velani
Përmendorëve u duhen Lule dhe Rreze
Edhe katër ushtarë i ka Nëna Zade e ndjerë
Me këmishë të Zemrave e veshin
Pranverën me Lule Gjaku
Dhe me Lule të Lirisë.

ISUF GRAJÇEVCI

ZËRI I TIJ

Sa herë vjen marsi
Pranvera mbushet pikëllim
Për ty shkëmbgraniti
Ata që t'i prangosen shkronjat
E ta vranë diturinë
Të goditën tinëzisht
Atë ditë pranvere
U tundën bjeshkët
U dremit Bistrica
Kur trupin tënd
E kafshoi dorë e krimit
Tym i zi e mbuloi qiellin
E lulet pikuan gjak
Zë i atdheut jehoi

Vendi është në tym e flakë
Ta mbrojmë atë të gjithë bashkë
S'tu tremb syri o zog petriti
Zëri yt në male buçiti
N'demonstratë të gjithë tok
Robëria s'duron lot
Sot për ty thurim vargje
Krenaria jonë kombëtare

KUMRIJE QORRAJ-BRUQI

PLUMBAT NUK E VRANË LIRINË

(Kujtim për vëllaun tim - Ismet Avdi Qorraj-1968-1989)

Plumbat dum-dum, as e mposhtën as e vranë lirinë
Mëmëdheu jetoi edhe pas kësaj katrahure vrastare
Kosova sot frymon e gjallë
Ismet, Ti- gjurmë e gjakut atdhetar
në rrugën e gjatë të pavdekësisë

Tribun e liberator i atdhedashurisë

Shqiponjë e vrarë nga pushka e sllavit
Dihet se shqiponja e vret korbin

edhe me shpirtin plot sakrificë

Dhe dihet se gjaku yt lind lulekuqe
Sllavët këputën lulekuqen me aromë vdekje
Shkelën mbi gjakun e Ismet Qorrajt, Agim
Kuklecit, Salih Hadërgjonajt dhe Mujë Mehmetajt...
Ju lashë të lirë në varre pa qizmen barbare

Juve, engjëjt e lirisë ju morën lartë në qiell
Nga lart sytë i keni plot mall për babanë, nënën, motrat,
Shpirtrat Tuaj, ia falët Kosovës së Lirë.

Nga horizontet e pavdekësisë na thoni:
Mos qani në liri, vetëm flisni për ne, na kujtoni:
Ne jemi gjallë në përjetësi: unë- Ismeti, Agimi,
Salihu dhe Muji
Jemi engjëj lirie
Rreze drite përmbi Dheatdheun tonë
ardhmërisë së tij i bëjmë Dritë...
Jemi këtu me ju, popull...

Sikur ma dëfton një kujtim këtë zë të Ismetit,
Agimit, Salihut, Mujit që na flasin nga parajsa:
Gjaku ynë do të lind mijëra kryetrima,
s'është gjak i humbur asnjëherë
është gjak që vadit ardhmërinë kombëtare
t'përjetësisë

Mbi heroizmin tuaj liria ka lëshuar rrënjët e atdhedashurisë
Jeni vetë rrezja e diellit që rrezaton Kosovën
Ju, engjëjt e Atdheut, histori e shkruar me pushkë e gjak

Për t'mos shterrur kurrën gjakun e saj liria...
Ju jeni vetë Kosova, ndaj ju kujton gjëmëmadhe Shqipëria.

Prishtinë, 9.3.2015

LINDITË RAMUSHI DUSHKU

RRUGËN TËNDE

Mes dhimbjeve të kohës së fjetur
s'kish si fle shpirti
që ndjek ëndrrën e përtejme të lirisë
atëherë kur dritat shuheshin mbi tarracat e shtëpive
e loja e fëmijeve ngazëllente erërave të kohës.

Çfarë mund të ndizte mes vërshimeve
rrugën që more
se ish më e madhe
se sa aroma e trupit që mbeti në shtëpi
dhe sytë që do të lotonin për ty
...por kjo ish më e madhe se çdo gjë

më e brishtë se brishtësia
më e pastër se vet amshimi që preku ballin tënd
çfarë mund të ndalte tjetër rrugën që more
ti mes zjarrit të luftës
tani që lutemi ta shijosh
ti mes plumbit të shtypur
e zemrat tona me mallin prush.

Ti paske fjetur tani
dhe ç'mund të të kendoj
mbi lulet tua sipër rilindjes
ke prekur dritën e madhe të diellit
që sot ngroh ditët tona.

MIMOZA LEGISI

NJË EMËR NDËR YJE

Fuqishëm malet sot po rënkojnë,
dhimbja në heshtje po ushton,
nën qiellin e zymtë përmbi Kosovë
buzë pragut nëna, nis dhe vajton.

Plagët e kohës kullojnë gjak
këngën kanë ndalur bilbilat,
djemtë e shqipes kërkojnë hak
të mposhtin të mallkuarat bisha.

Deqani ka ulur kokën n'heshtim
një trim nga krahët i'u largua.
Ismet Qorraj, sdo ketë me kthim
në lulkuqe gjaku i'u shndërrua

S'do jetë mes nesh mbrëmjeve të vona
yjet kanë shkruar emrin e tij
kur malli të marrë vëllezër dhe motra
për të do qëndisen vargje gjithnji

Fjalen "Liri" shqiptoi goja e tij
kur trupin ia fali vatanit,
Ismetin s'e trembi as blumbi i zi
do jetë krenaria e Deçanit

MIGENA ARLLATI

BURRAT VDESIN NË MARS

Moti këndohet "Kënga e marsit" këtyre anëve,
se marsi dhe pranvera vijnë bashkë me të kuqen e gjakut,
nuk rreshtin minatorët, studentët e punëtorët
Kosova ka plot njerëz që i dalin zot.

Turma dridh malet, kërkon "Liri-Demokraci",
"Kosova Republikë" thërret një popull i tërë,
nuk ka pranga që dëshirën për liri të prangosë
pëllumbat e bardhë ndjellin veç paqe dhe shpresë.

Por hija e zezë shtrihet mbi krena
hesht burri i dheut, fjalën ia mori qielli,
me zërin e jetës kënga e vdekjes jehoi
me gërma të arta historia emrin lart ia përjetësoi.

Ngrehu o Ismet Qorraj hej trim
se burrat kanë prapë luftë për të bërë,
i duhen Kosovës djemtë në ballë
trima me këmishë që ka ba veç nji nanë.

E morën një pas një plumbat
siç vriten trimat në kraharuar tej për tej,
e shpuan ndër deje, gjaku flamurin vërshoi
mbi krahë shqiponjash në historinë e re parakaloi.

Plumbat dhe pëllumbat shkojnë e vijnë në ajër
të parët marrin jetë, të dytët parandjejnë lirinë,
se liria pa plumba për shqiptarët qenka e vështirë
me këngë në gojë vdesin këta bij.

Dhe marsi ja ku vjen prapë mes nesh
toka mbushur lule, mbjellë me dëshmorë,
një jetë që kishin e dhanë për ne,
djemtë më të mirë lulegjak mbeten prore!

MONA AGRIGOROAIEI

LIRIA I KA RRËNJET NË GJAK!

Liria i ka rrënjet në gjak.
Për këtë flasin dielli e qielli i paanë,
Barrikadat e qëndresës po i japin armikut dajak,
Në demonstrata anëmbanë.

Në rrugë, në sheshe, në shtigjet e jetës
Shokët nuk kanë kompromis, vazhdojnë.
Kushtetutën e lirisë ta mbrojnë
Kundër moçalëve të pavërtetës.

Liria afirmohet me ideal.
Kur, grushtat bërtasin kundër shushunjave!
Kur, në jetë nuk qendron vasal
Ismeti, djaloshi i barrikadave.

Ismeti, simbol i përkushtimit
Në rrugën e Lirisë.
Ismeti, dëshmor i qëndrimit
Kundër ujqërve të Serbisë.

Rumani, 3 mars 2015

MENTOR THAQI

TETËDHJETË E NËNTË THYERJE REFLEKTUESE....

RRËFIM KOHE

u ça pasqyrë e fundshekullit
në tetëdhjetë e nëntë thyerje reflektuese,
mozaik gjithëfarësh, imZot ...
në mes sall kuq e zi

e bardha nga larg vinte,
larg... shihnin largpamësit

kjesh vetë aty... e pashë
para sysh, copë-copë u thy

djemtë dolën para zjarri,
flakëpërflakë ... me hapës varri

ah, heronjtë e mi,
ju që falnit, jepnit zemër, moral, dashuri ...

Ismeti i nënës, Agimi i vëllaut, Salihu i motres,
Ragipi, Syla, Muja ... Mentori tevona,
Djem të Votrës, që vrisnin zezona

atë ditë ... më tha vëllau Alberti
kur po kafshonte dhëmbë e dhimbje
... lëre plagën time, shëro plagë Kombi, vëlla,
koha e lëmëritjeve iku

fjalët vonojn, ne saora n´Kuvend t´Pajtimit,
Verrat e Llukës hapekrahë ...
për ata njëqind, duhej shpagim,
njëmij t´shpëtohen, dhjetëmij t´ruhen

për ty Shqipni, Dardani ...
po a nuk ishte ky kushtrimi,
a nuk ishte ky kthjellimi ... imZot
...

MUSA JUPOLLI

NOBELIZMI I DJALIT TË RI

28 marsi i vitit 1989
Nga trupi i trimit muarëm ngjyrë
Me shkronja kuqezi
N'ideal t'Atdheut shkruam emrin LIRI
Ismat djali
Legjendë e Dardanisë
Sot hero i poezisë
Në gramatikën tonë
Sa me mall të përkujtojmë
Sa bukuri ka vendëlindja jote Ismet Qorraj
Aq lule syri do shkruajmë për Ty
Sa fjalë që fole për Atdhe
Aq ngrohtësi shpirti do të dhurojmë Ty
Sa trokiti liria në zemrën tënde

Aq poemë Arbërie do t’i kushtojmë TY
Sa kujtesë malli i prindërve Tu
Biografi në bibliotekën tonë
Aq vargje me zë të lartë do t'i recitojmë
Hëna e pa lotin e Valbonës
Para se aurorë e parë e ditës
Dielli ndriti male e fusha
Për Atdhe në përqafim
Lyrë në frymëzim
Penë e premtuar
Himn me Flamur në dorë
Një zë m'erdhi nga qielli
Nobelizmi i djalit të Ri
Ismet Qorraj i Avdisë
Krenaria e Çarrabregut
Deçan e tërë Arbëria
Lulet më të bukura ujitën
Për flamurtarin e Lirisë
Lot e varg i Dardanisë
Në krah të Shqiponjës pikturuam
Pamjën tënde t'Hujnishme
Dashurinë o atdhetar që kem për Ty
O Hero i Shqipërisë

MEVLYDE MEZINI SARAÇI

NDËRRIM STINËSH

Nuk ka plumba që vrasin lirinë e atdheut
Ata shkëputën për një çast ëndrrat rinore
Ti shkëlqen me yjet në lartësinë e merituar
Jeton me këngën me vargun e poezisë
Nuk plakesh nga vitet në ecje rinohesh
Me kurorë pavarësie shpirt dëshmori
I ri si syth pranvere shpërthen emri yt
Në ndërrim stinësh e festash buçet kënga
Nuk ka plumba që vrasin shpirtin tënd Ismet

Nami yt rritet bashkë me këngën e lirisë së atdheut
Syri yt shqiponjë stolisë flamurin kombëtar
Valëvitet lart i rrethuar me pëllumbat e bardhë
Në logun e betejës rilinden vetëm trimat e atdheut
Për t'u ringjallur feniks bashkë me lirinë
Ismet këngë e përkundur në djepin e atdheut
Emri yt jeton në liri e rritet në shekuj pa mbarim

NEBIH BUNJAKU

KUR FSHIHEJ DIELLI

Kur fshihej dielli prapa resh,
Korb të zeza me fortunë,
Plagë mbi plagë Pranvera jonë
Eklipsi njëshekullor- gjak e dhunë!

Lotonte qielli, gjëmonte toka,
Me dum-dum gjuante rrufeja.
Të patundur – Lisat n'këmbë,
Për liri, për ditë të reja...

Mbushej sheshi me Shqiponja,
Për ta mbrojtur çdo Fole,
Me flamuj e me pankarta
Për liri dhe për Atdhe.

Shkabë Flamuri- Ismet Qorraj
Me tre vëllezër, me tre trima,
Hapën Portën e Lirisë
Rrufepritës për vetëtima.

Sali Hadergjonaj – dragua Vokshi,
Mujë Mehmetaj nga Maznika,
Agim Kukleci – luan Isniqi,
Nuk e dinë se çka është frika.

Ndonëse u mori t'njomë liria,
Ismet Qorraj s'jeni fajtorë,
N'Lapidar, në pavdekësi
Për liri gjithmonë-Dëshmorë.

RAJMONDA MALEÇKA

NJË SHQIPE MBI DEÇAN

Vrapon dritë e shekujve e ndalet në sytë e djaloshit,
Dritë nëpër gjëmime, dhimbje, lindje e deka që pa,
Në parzmën e ballit ku ndrin krenari e besë e burrit,
Dritën e ndritshme të shekujve djaloshit Ismet
Qorraj ia dha.

Vrapojnë luftëtarët e shekujve e ndalin në
dashurinë e djalit,
Luftëtarë që zbrapsën ushtri, hasëm e tundën
Perandori,
S'e ndalon ardhacak a diktaturë atdhedashurinë në
zemër me e ndry,
Se Njizetë e një shekujt shqiptarë mbi shpinë i ka ai.

E andrra e lirisë u bë fytyrë e bukur djaloshare,
21 vjeçare në jetë të jetëve fytyra e djalit, trojeve do
të mbesë,
Do të shkojnë e vijnë brezat, e malet do të thinjën
nga motet,
Ismet Qorraj në rini të tij të ardhmen do të presë.

Nëpër odat e Deçanit gjithmonë do të kuvendojnë
burrëria,
Djelmëria e lirisë do ta ndrijë fytyrën e tyre në çdo
mot,
Ismet Qorraj bukur i ka lidhë kohët e trimave në 21
vite jetë,
Është bërë istikam, asnjë pushtues nuk e mposht
dot.

Nëpër çdo stinë bëhet diell lirie rinia e djaloshit,
Thinjë në flokët e nanave, dhimbë tek motrat e
Deçanit,
Si gurët e zgjedhur për kullën po mblidhen kangët,
kujtimet,
N'fjalë e besë burrërie me ia pa jetën luftëtarit.

Sa t'jetë jeta yll i mëngjeseve në dritaret e Deçanit,
Sa t'jetë liria n'karvanin e trimërisë ai prijatarë,
Sa t'ketë shqipe në bjeshkët e Kosovës e shqiptarisë,
Ismet Qorraj n'rreze drite petkat e shtatit i ka varë...

Është e bukur rini e përjetshme, pa rudhë në ballë e flokë thinjë,
Vetëm nënëmadhja liri këto djem e vajza mund t'i lindë,
Siç don atdheu forcë e vrullë djaloshare me u mbajtë në këmbë,
Dhe karvanet e historisë me luftëtarë, në udhë don rininë.

REMZIJE ZEKOLLI

FLAS ME TY KRYETRIM

Nën shiun e kohës
Endem vetmisë dhe mendoj
Ku mund të kryqzohet rruga
Te ura apo te kroi i syrit

Pika e lotit është lumi që ik
E krahu i majtë i udhës
Vjen nga e majta e ëndrrës
Krahu i djathtë i ëndrrës
Vjen nga e djatha e udhës

Rruga ndanë apo bashkon
Përgjigie nuk kam
Kurse zjarri digjet e digjet
Nën shiun e kohës memece

Populli im si ta gjejmë kohën
Si ta gjejmë rrugën mes nesh

....Ciceroni fliste
Për historinë e Ismet trimit
Që dikur moti kisha dëgjuar
për ty
E tash ti je i veshur në bronz
me bukurinë tënde magjepse...
Nuk e dij
A ti më sodit mua
-apo unë ty
Nën hijen e blirit shtatëhedhur
Që Ti e mbolle o kryetrim
unë rri e flas
me ty
deri në amshim!...

RAMI KAMBERI

SYVE TË PLISIT

Flaka rrufe
Ua dogji lulet e pranverës
Për ditëlindjen e gjuhës
Që pagëzoi truallin dalë prej flakës së zjarreve
Klithmat e dhimbjeve
I kalonin shikimet që preknin qiellin shtatzënë
Në grykën e purgatorit
Perënditë
Stërpiknin me riga shprese agun e nisur kah toka e dalë prej zjarreve
NGA TERRI I ZJARREVE
Ngjyra dëshmie
Duke shtrydhur shekuj
Dalin nga koha e moteve
Për ta kthyer kujtesën
Mes shikimeve të përgjumur harresë
Piramida histori
Kthehet tek shkronjat e para

Për të gjetur gjuhën e vet
Sytë
Prekin kohën e miteve dhe legjendave
Shikimet
Thithin gjinjtë e tokës deri tek rrënjët
Me gjuhën pjella del nga terri i zjarreve pellazgia
PËR INATË TË LUFTËS QË I PRINTE BISHTI I DHELPRËS
Duke shtrydhur dashurinë
Me zjarrin e shpirtit
U kthye në motin e legjendës së lumturisë të kalbur nga lotët
Shikimet e lindjeve e rrahin
Bashkë me namet e çmendura në gjak
Për luftën që matej me bishtin e dhelprës
Vrojtimet me serti të akullt
Motin e kohës ja shpojnë
Me etjen e madhe në sy
Me këngët e terura
E të tymosura nga kullat e humbura mes gurëve e barit mbi oxhaqe
U këndonte kobëve
Ndaloj këngën
Duke pështyrë
Zjarrin e shpirtit
Para humnerës pa fund shpirtin ia la truallit ta shkrinte në zjarrin e ferrit
Për inat të luftës që matej me bishtin e dhelprës

SHAHBAZE VISHAJ-GRAJÇEVCI

SHKRONJA I. E VIZATUAR

Ismetin shpesh e ëndrrojmë
Në malet e Pashtrikut
Duke luftuar fyta-fyt me ujq
Atje te Guri i kufirit
Lisat pikojnë gjak
E rrezja e lirisë
Ka shkrirë Borën shekullore
Nëna çdo natë në oborr flet me hënën
Loti i saj bashkohet
me pikëllimin e hënës dhe yllit
Të cilët në çdo gurë
E ndriçojnë fjalën liri
Nën hijen e Kumbullës së vjetër
Nëna e gjyshja pushojnë

E kanë kujtim nga djali
Që ia vranë në demonstrata
Në trup të saj është vizatuar shkronja I.
Kur u nis për në demonstratë
Te Kumbulla e përqafoi fort
Nga ajo ditë frutat pikojnë lot
Sot kudo sytë e saj
Kërkojnë hijen tënde
E në dhomën e gjumit të pret babai
Ku kujtimet për ty i janë shëndrruar
Në lotore ngashërrimi
Ndërsa nëna e dëshpëruar
Ende kërkon ilaç
Për zemrën e copëtuar

SHKURTA (MUSA) JANUZI

KU MBETE TRIM

Herën e fundit të pashë në rrugë
Teksa thërrisje për liri, paqe, pëllumba
Të pashë krah për krah me shokë
Tek vërshonit kundër furtunës me plumba

Buzëqesha kur i ngrite lart dy gishta
Të duarve të krijuara për laps, dituri
M'u bë zemra mal, sikur mora krahë
Për ju që trima të paepur qëndronit në shi

Për katër orë rresht të përcolla pa nda
Teksa burrërisht mbroje tokën amë
Guximin e kishe të rrënjosur në zemër
E gurët e tokës, të vetmet armë

Por ç'mu err shikimi në një çast
Zbarkuan gjakatarët, ty nuk të pashë më
Kot kërkova me muaj e vite
Që në mes të thirrjeve, të dëgjoj dhe tëndin zë

Të thirra emrin fort, ndërkohë që rrugët u zbrazën
E dheu u pa, me gjak të njomë mbuluar
E gënjeva veten se s'desha ta pranoja
Se aty po thahej dhe gjaku yt i kulluar

Kot prita në ankth, ti nuk erdhe
Ndaj bashkë me erërat ulëriva: Ku mbete trim?
Para meje u shfaqën burrat me arkivol mbi supe
Dhe reflektimin tënd e pashë në çdo shikim

Dhe u thava në çast, u bëra shkrumb
Në këtë qytet, unë më i vjetri plep
Se nuk më bëri shpirti ta shihja në varr
Djalkën që bashkë me erën, e patëm përkëdhelë që
në djep

Në mesin e plumbave, breshërit, gazit
Të morrën, të tretën nga ne okupatorët
Të pashpirtët, katilët se kuptoin dot
Se nuk vdesin asnjëherë trimat, dëshmorët

Nuk shuhet heroi nga plumbi, por vetëm gjallëron
Jeton në kujtime, këngë e poezi
Frymon bashkë me erën, malin dhe lumin
Dhe me mua plepin e moçëm që iu bëra kornizë,
tëndes fotografi

TEUTA A. MUJI

DËSHMORIT ISMET QORRAJ

Thonë dëshmor ra Ismeti
Po pyet nëna ku mbeti?
Nëna e shkretë, po përmbytej në lotë
Ktheu kokën nga i madhi Zot
S'gjente dot fjalë, as fjali
Por... i erdhi një fuqi
Pse jo mua? O Zot, por tim bir...
Pse më morët djalin më të mirë
Pse më latë kështu, pa shpresë
Pse ma latë lotin përjetë!!
Zgjohu nënë!
Zgjohu nënë e shiko rrotull
Sa dëshmor sheh anë e mbanë
Trimat tanë, ranë për vatan
Zgjohu nënë e shiko qiellin
Ngrite kokën e shiko diellin.
Edhe ai është strukur diku në hapsirë,
kërkon pamje më të mire

Mos i qani djemt tanë trima
Mos i vajtoni këto ditë të këqia
Se do të vijnë ditë shumë më të mira
Trimat tanë, ranë për Liri
Se s`duruan dot padrejtësi
Kosova po përmbytet në lot e gjak
Flet bota anë e mbanë
Për trimërinë e djemve tanë
Thonë shqiptarët sypatrembur
Që të gjithë janë në luftë, po përballen me çdo kusht!!
Të fortë si shkëmb e si gur
Për një komb, për një flamur.
Seç u zgjua nëna me shpejtësi
E mbuloi djalin e ri
Hallall gjiri biri im, paskam pas djalin trim !!
Ismet Qorraj, me shokë të tij
Ju dëshmor, shehid të rinj..
Do të mbeteni në histori
Se dhatë jetën për Liri.
Historinë përherë do t'ua tregojmë
Me shumë krenari brezave të ri
Por jo si tmerr
Mos harroni thonë
Pas shiut ...
Ka ylber!!

VULLNET R. MATO

O MOJ NËNA E ISMET TRIMIT

Mos qaj, moj nëna e Ismet trimit,
se biri yt në ballë të kushtrimit,
ra si yll i këputur që flakëron dritë,
për kushtetutën Kosova-republikë.

Ai bëri frymën zjarr në demonstratë,
të bëhej shkrumb e hi robëria e gjatë,
të fitonte lirinë e gjithë Kosova
Deçani, Mitrovica, Gjilani, Gjakova...

Moj nënë, ai fundmarsi i Ismetit,
Ishte thirrje për fundin e kiametit,
të shporrej çizmja sllave në çdo anë,
kufijve të lashtë të truallit Ilirian.

Ismeti u vërsul në ballë të betejës,
pa përfillur plumba e gaz lotsjellës.
Ai u priu trimave në atë log trimash,
si sokol krahëhapur mes vetëtimash.

Dhe aty përballë hijenave të policisë,
shpalli vendimin e dënimit të Serbisë,
fatin që i priste të gjithë barbarët,
pasi të rroknin armët kosovarët...

Si të gjithë trimat, në çaste heroike,
Ismeti tha për ty, moj nënë stoike:
"Mos loto për mue, amanet kam lanë,
se të kam nderue ty e Kosovën-nanë!"

Hakun e birit tënd njëzetenjë vjeçar,
morën mijëra djem e vajza kosovarë,
në rreshtat e UÇK-ës legjendare,
prandaj, moj nënë, mos qaj në varre;

Se biri yt dhe një tjetër jetë të kishte,
prapë në ballë të betejës do të ishte,
se ai kishte në deje gjak shqiptari,
dhe për pavarësi do të sulej i pari...

O moj nënë dardane, nënë heroi,
Ismeti yt ra që Kosova të rrojë,

prandaj ai trim nuk ka vdekur,
është sërish i gjallë e zemërhekur.

Dhe nuk ka për të vdekur kurrë,
se u bë shqipe për flamurë,
të valëvitej mes luftës e acarit,
në batalionin e Adem Jasharit,

Më pas kur e prisje të bëhej burrë,
të sillte në shtëpi nusen me flamur,
u bë dhëndër heroik i bajrakut kuqezi,
në dasmën e madhe Kosovë-Shqipëri.

VJOLLCA TIKU PASKU

BRENDA DRITËS SË NJË YLLI

Sot dua të thërras një emër, Ismet Qorraj!

Heshtja qëndron si ajri i frikësuar në gjurmët e vijës që përshkon plumbi , në gjoksin e të vrarit. Sot dua ti lutem qiellit të mos zemërohet nga skenat e kujtesës në tokë.

Pikërisht në ditën e njëzetetetë Mars disa frymëmarrje u këputën. Rrotat e hekurta të tankeve serb shfrynë mllefin e zi rrugëve të Deçanit për të shtypur demonstratën e zemrave liridashëse kosovare.

Ismet o djalë, o bir, o martir, o dëshmor!

Plumbat e zinj ndalen orët e jetës tënde. Pranvera e Marsit veshi fustanin e zi. Vesa e mëngjeseve u bë e kripur. Zemrat e të dashurve të tu vajtuan me

britma dhimbjesh, spërkatjen e tokës me gjakun tënd. Zëri yt heshti në thirrjen për liri.

Oh liri e larë me gjakun e jetëve njerëzore. Liri që qëndron e mbledhur brenda grushteve të cilat tunden në ajër dhe zanoreve në fytet rinore.

Liri fjalë me konture të lulëkuqeve që i qëndrojnë përjetësisht kohës, fjalë me veshjen e argjend të hënës , fjalë e thirrur shumë herë si dallgët blu të detit që shkumëzohen në breg.

Ismet o djalë, o bir, o martir, o dëshmor!

Ju ecët në rrugët e Decanit të kapur dorë për dore të bëre gardh ndaj errësirës serbe , për të dhënë dritën e jetës tuaj mëmëdheut , me zemrën e mbushur plot e për përplot dashuri për Kosovën heroike.
Sytë tuaj shikonin hartën e Kosovës së lirë, në buzëqeshjen tuaj shkruhej e ardhmja , në zemrat tuaja çelnin trëndafilat e lirisë.

Ismet o djalë, o bir, o martir, o dëshmor!

Parafytyroje të ardhmen pa hijet serbe, parafytyroje lirinë e mësimit dhe gjuhës shqipe, një nga gjuhët më të lashta të botës, më e ëmbël ligjëruar nga fiset dardane.

Parafytyroje valëvitjen e flamurit shqiptar në flladitjen e stinëve. Ti parafytyroje si mund të puthje një copëz flamuri e të ndjeje shijen e lirisë.

Ti parafytyroje si mund të ndihet zemra e lirë në vendin e shqiponjave. Ti parafytyroje të qeshurat e lumtura të fëmijëve dhe paqen e ëndërruar.

Ismet o djalë, martir, o dëshmor!

Ti je një yll i përjetshëm. Në heshtjen e kuqëlimit tënd , në paqen e misterit tënd nga sytë e qiellit ti sheh lirinë.

Por ah sikur kjo liri frytdhënëse të ishte e shoqëruar me buzëqeshjet dhe fjalët e sinqerta të ishte një liri e butë, e ëmbël dhe jo e egër, e varfër....

Në dritën e yllit tënd të pavdekshëm emri yt do përkujtohet brezave për tu nderuar gjithmonë si Ismeti liridashës.

Ngjyra e kuqe e yllit tënd dhe yjeve të tjerë që ranë për liri ndriçon Kosovën heroike. Lavdi veprës tuaj!

XHELADIN A. ÇITAKU

OBELISK PËRJETËSIE

Vatër e ndezura n'prushërim shekujsh të krrusur
nuk shuhet dot nga erë e acartë dimri t`ciknosur
ngrohtësi shpirtin n'lashtësi legjendash mbushur
furtunës n`përflakje përcëllimi gjoksin shpalosur

Katranosur zijoshët, marshojnë lemerishëm
ktjelltësinë mynxyrshëm e qëllojnë vetëtima
n'sokëllima egërsisht, n'vërshuarje furishëm
shkrepash varur mnershëm, me hungërima

Tërbim hienash n'ulërimë çjerrëse trollit i sulen
rrufe goditëse pamshirshëm zbrazen qiellit t`nxirë
toka rënkonte, n'përballje trimëritë s`përkulen
n'errësirë humnerash s'qëndron dot shpirti i lirë

Nëpër mote kalitur n'ideale t'zjarrta që s'tunden
N'flakërima kalëruar rrëmbyeshëm Ismet trimi
lukuni barbarësh ta çrrënjosin dot nuk munden
nga rrënjët ngulitur n'thellësi, del llavë mallkimi

Radhët shtërnguar n'marshime lirie krenarë
N'balada t'lashta himne madhështisë kënduar
kokën lartë patrembur nga pancir e hanxharë
prinë Ismet Qorraj me flamurshkabën valuar

Syrin shqiponjë, vrullshëm errësirën përballur
plumbat sfiduar me zemrën valë në afshërime
hero Ismeti, me zvarranikë t'helmatisjes tallur
me tyta t'barbarisë të harbuara në shfrenime

N'shtatore simbol, ndër shtigje ndriçon fanar
ndrinë n'kujtime breznishë, obelisk lartësuar
rrezëllime përjetësisht n'horizonte shpërndarë
shpirt vetmohimi n'altar pavdekësie nderuar...

XHELADIN MJEKU

NUK BESONTE NË PËRRRALLA TË KUQE

Vonë ishte, tepër vonë
Të besonte në përralla të kuqe
Se atdheu do të vishej me vello
Do të zbukurohej si nuse

Ishte kohë shtrigash atëbotë
Ku digjej gjithçka që në embrion
Veç boshësisë së fjalëve
Tjetër asgjë s'të kujton

Iu kthye kujtesës njëherë
Nga fillimi i ditës
Kur bisha sulej e qartur
Dhe shembte tempujt e dritës

As plumbi në flurudhë
As topi e bajoneta
Nuk ia ndaluan rrugëtimin
Të kaptoj ëndrrat e veta

Mbi maja shkëmbinjësh
Si skifterë që nuk e lëkund stuhia
I kalitur brezave të historisë
E ftonte në përqafim liria

Me fjalën si shigjetë
Dhe me gjoksin shkëmb
Mundi bishën gjakatare
Rrufetë i ndaloi me dhëmbë

Vërtetë ishte vonë
Të besonte në përralla të kuqe
Se atdheu do të vishej me vello
Do të zbukurohej si nuse

Me besim në zemër iu fal
Kushtrimit të Skënderbeut
Flamurin e lirisë
Ia shpalosi atdheut

Prandaj në çdo vend
Ku shqipja u njomë me gjak
Lapidar i trimave të këtillë
Qëndron si bajrak

ZEF PERGEGA

ISMETI I DEÇANIT NDERI I VATANIT

O nanëlokja e dheut dardan
Shekujt me çerdhe korbash mbi supe të peshuan
E ti nuk u krruse e as u tute, nana trime
Se djepat i përkunde me këngë e flijime
Buken e kakise se trollit tend e mekove
Me qumështin e zanave të detit dallgë dhimbje

Heronjt që i puthe në ballë para betejes
E dhanë jetën për liri
Politikanët e sotëm haremeve të krimit
Me gjakun e tyre i trokasin gotat për lavdi

Mbi sythet e marsit rrebesh me plumba
Shpirtit te revoltes, Ismet Pranvera, i priu
Po nuk i vrane dot pëllumbat

Se nuk kane lindur ti mbërrijë plisat,serbziu
Në ballin e dejeve të gjakut të përflakur
Me shkronjat e eshtrave të heroizmit të Deçanit
Shkruar është një emër
Ismet Avdi Qorraj në pllakë të vatanit
Ai me një dorë mbi Dhe
E me tjetrën valzon kujtimet e te rënëve
Me i gjallë se të vdekurit ndër ne!

ZEQIR FAZLIU

GACËZA E KUQE

Bashkë me ngjyrën e verdhë të gjetheve
në brendi të turmës
Nuk ishte vetëm fillimi i krismave

Tani karvani i bardhë i plisave
ngjitet përpjetë Alpeve të Namura
si pulëbardhat

Mungonte dielli mbi gjethe
për t'i mjekuar
ëndrrat biblike

Në portën e Kullës së madhe
e hodhen shkrepsën në momente delikate
e zgjodhen më të mrekullueshmën
gacëzën e kuqe

Nga mrekullia e shkrepsës së verdhë
meteori shkëputet si hëna
shpërndahet ritmikisht nëpë gurë...

Gjithçka është tani me ngjyrën e bardhë
brenda shpirtit e shtëpisë

XHEVDET QORRAJ

(rrëfim për herë të parë nga vëllai i dëshmorit)

VDEKJA E ISMETIT NA BËRI MË TË FORTË

....Deri në ora 11.30 të datës 28 mar 1989 Ismeti ishte duke punuar në depo....

Disa minuta më vonë Ismeti me shumë shokë ju bashkuan demostruesve afër komunës tonë (Deçan)... Ai vazhdimisht i gjuante policinë më gurë e sende tjera.

Policia ishte në fillim e përzierë : shqiptarë dhe serbo-malazezë... Policët fillimisht tentonin t'i shpërndanin me gaz lotësjellës demostruesit.

Ata (Policia e Deçanit) deri në një kohë nuk kanë përdorur armët, përpos bombave lotësjellëse.

Turma shtohej në vazhdimësi (mbi 10.000 demostrues të moshave dhe strukturave të ndrushme).

Në ndërkohë nga Peja, në drejtim të Deçanit, erdhën njësitë e blinduara (Njësitë Speciale të Policisë Federale Jugosllave) dhe me shpejtësi, pa paralajmrim, kanë filluar të gjuajnë në drejtim të demostruesve afër depos së ish "Gërmisë"në Deçan.

Rreth 200 metra larg ndërtesës së "Gërmisë" (në drejtim të fshatit Carrabreg), një plumb dum-dum (në shpinë) e plandosi Ismetin. Nga krahërori i tij i shpuar rridhte gjaku.

I plagosur Ismeti më tha : "Xhevdet, vëlla jam plagosur... Mbamë". E kapa për krahësh dhe e tërhjeka zvarrë përafërsisht rreth 100 metra në drejtim të oborrit të shtëpisë së Dinë Ahmetit.

***

Në ndërkohë erdhi dhe vëllai yni Muhameti, si dhe bashkëfshatari -Agron Gjonaj.

Ismetit, nën stres, gazë lotsjellës, ia dhamë ndihmën e parë... Ishim në panik për gjakderdhjen e madhe të tij nga krahërori. Pas një kohe të shkurtër kishte dëgjuar vëllai i ynë i madh Xuni, se Ismeti është plagosur rëndë.

Na 3 vëllzërit, me Ismetin e plagosur muarëm një automobil dhe u nisëm drejt për në spital të Gjakovës.

***

Aty tek Ura e Binakëve (Carrabreg i Ultë) na ndaluan Njësitë e Policisë Speciale të ish Jugosllavisë.

Na maltertuan dhe ofenduan bukur shumë... Xuni më zhdërvjellësinë e tij prej vozitësi nuk i përfilli rregullat dhe urdhërat e specialcëve serbo-malazezë, por më një shpejtësi të madhe pa pritur përgjegjën e tyre, u nis për në spitalin e Gjakovës.

Mbas 10 minutave kemi arrijtë në spital. Koridoret gumëzhinin nga të plagosurit që kishin ardhur nga Komuna e Deçanit dhe ajo e Rahovecit.
Mjekët na thanë : Do e operojmë, por gjasat janë shumë të vogla që të kemi sukses!

E, Ismeti nuk e priti operacionin... Ai ndërroi jetë, pa bërë as uf...
Babai, nëna, me 5 motra dhe 4 vëllëzër nuk lëshuam asnjë zë, ishim të mpirë... Ishte sugari ynë... më trimi.

E tërë familja dhembjen e madhe e kishin shndërruar në forcë.

***

Tërë Kosova ishte në kryeshënosh... Në mesin e tyre ishte edhe komandanti Hamzë Shaban Jashari nga Prekazi i Drenicës, e mijëra burra, gra e vasha të reja nga tërë Kosova...

MONA AGRIGOROAIEI

"SOT ËSHTË POPULLI NË RRUGË, NESËR DO TË JETË NË MALE!"

(Tregim, kushtuar dëshmorit të kombit, Ismet Qorraj, në 26 vjet prej rënies së tij, në demonstratën e 28 marsit 1989)

Duke rropatur në dhomë me shpejtësi, Ismeti mezi mori frymë dhe u tha shokëve:
-Shokë, sot janë demonstrata! Duhet patjetër të shkojmë!. Nuk duhet të lëmë këmbë serbi të shkel mbi Kushtetutën tonë, e cila është shpallur në Kaçanik, me mundime dhe sakrifica.
-Do të marrim pjesë, treguan në një zë, shokët e tij.
-Jo vetëm se duhet të marrim pjesë, por duhet të ndihmojmë komitetin e organizimit. Kam hyrë në

kontakt me shokët udhëheqës. Duhet të shpërndajmë trakte nëpër rrugët dhe shtëpitë e Deçanit.
-Dëgjoni shokë, ne duhet të dalim në mbrojtje të Kushtetutës, e cila ka argument vullnetin gjithpopullor i popullit të Kosovës për liri dhe vetëvendosje, tregoi me vendosmëri të palëkundur, Ismeti.
-E ke të drejtë, o shok, dhe në duhet të bëjmë detyrën tonë dhe, si popull të tërë të ballafaqojmë pushtuesin. Propozoj të shkojmë te shokët e komitetit organizues të demonstratave dhe të marrim trakte për t'i shpërndarë.
-Të shkojmë në shkollë dhe të flasim me ish mësuesin tim. Ai bën pjesë prej komitetit organizues, tha Ismeti dhe hapi derën e banesës, duke dalur në rrugë.

* * *

Mëngjes me erë që të hynte në lëkurë. Një shi i zymtë po fshikëllonte fytyrat e djelmoshave. Akoma pranvera nuk shihej në horizont, ishte një të ftohtë i vrazhdë sa edhe vet kohërat në të cilat jetonin. Do të derdhej shumë djersë e gjak deri në liri, por djemtë ishin të vendosur. Nuk donin t'u shmangeshin detyrave. Si çdo i ri i Kosovës, të rritur në fshatrat anëmbanë Deçanit, edhe ata ishin të edukuar në frymën e atdhedashurisë dhe

përkushtimit për Nënën e tyre të dashur, Kosovë-Shqipërisë.
Djemtë u afruan shkollës. Aty, në udhëkryq të rrugëve, një patrullë serbe me tre policë.
-Ndalni, dokumentat!, u tha një prej policëve, me flokë të thinjur dhe më fytyrë të vrazhdë.
Djemtë nisën për të kërkuar nëpër çanta dokumentat. Polici i verifikoi dokumentat dhe gati u tha të lirë për të shkuar më tutje, por ndërroi mendjen. U tha: Çfarë keni nëpër çanta? Çantat në kontroll, dhe nisi për të kërkuar në çantat e tyre.
Në çantën e Ismetit e gjeti një objekt që shkëlqente. Ishte një flamur metalik shqiptar, me shqiponjen dykrenore, që Ismeti e kishte prej shokut të tij të bankës, që dikur udhëtoi ilegalisht në Shqipëri. Flamuri i tërhoqi vëmendjen policit. I bërtiste Ismetit me vrazhdësi. Çfarë është ky simbol irredentist?
-Ismeti, pa lëkundur, i tha. Nuk është simbol irredentist. Është një flamur kombëtar shqiptar. Në jemi shqiptare dhe kemi të drejtën të kemi flamurin tonë. Ju nuk do të na ndalni flamurin dhe të drejtat!
Fytyra e policit u egërsua. Dora i shkoi deri në brez dhe mori pistoletën;
i drejtoi Ismetit pistoletën me një gjest armiqësor.
-Qëlloni, qëlloni! tha Ismeti dhe hapi këmishën. Qëlloni ose na lironi rrugën!

Polici qëndroi një kohë, pastaj futi pistoletën në brez dhe tha:
-Shkoni, por ky simbol irredentist konfiskohet. Nuk duhet lejuar ta shohin edhe njerëz të tjerë.
Djemtë mbyllin çantat dhe polici mori flamurin metalik. Ata nisin për të shkuar në drejtim të shkollës. Ismeti ktheu kokën, duke e vështruar me mallëngjim dorën e policit kishte flamurin e tij. U tha shokëve: Flamuri është kujtim nga Shqipëria. Dhe ky ujk i egër ma mori! Do të hakmerrem! Do të dal në çdo demonstratë kundër pushtuesve serbë!
-Mos u mërzit, mirë se nuk pësuam më keq. Çfarë të bëjmë tani? Në shkollë nuk mund të shkojmë. Do t'u tërheqim vërejtjen policeve.
-Të presim të vijë ish mësuesin tim. Duhet të flasim me të për traktet.
Dhe, duke folur, u afrua një mesoburrë. Iu drejtua Ismetit: Ismet, duhet të shpërndani disa trakte. Duhet të mbledhim popullin për demonstratë. Ismeti iu përgjigj: Po, mësues. Por si duhet t'i shpërndajmë, se është prani e theksuar policore? Na ndalën horrat tani, kur ishim duke ardhur te ti. Mua më mori një flamur metalik. E kisha sendin më të dashur, kujtim nga Shqipëria Nënë...
Burri tha: Shperndajeni në rrugë dhe në dyert e shtëpive, ku nuk ka patrulla policie. Shkoni me mua tani.

Burri nisi për të ecur dhe djemtë e ndoqën. Shkuan deri në një rrobaqepësi. Aty, thirrën pronarin. Burri i tha: Kadri, jepji 100 trakte për person. Djema, fshiheni mirë të mos i kapin patrullat serbe. Shpërndarja e trakteve është përgjegjësi të madhe. Ju keni që tani ketë përgjegjësi. Materiali propagandistik nuk guxon të bie në duart e armikut!

Djemtë i futën në çantë dhe shkuan në banesë.

Atje, në banesë, Ismeti u tha shokëve: -Jemi tre, propozoj të ndahemi. Unë në një anë të rrugës, ju dy në një anë tjetër.

-Mirë, aprovoi një nga shokët dhe u ndanë. Ismeti shkoi në anën e dhjathtë të rrugës, duke vendosur traktet në derën e shtëpive. Traktet, kishin lajmërim për demonstratën e ditës së nesërme me tekstin: "Të mblidhemi të gjithë në qendër të Deçanit organizohet demonstrata mbarëpopullore kundër pushtuesit serb. Pjesëmarrja është e detyruar për çdo shqiptar. Të gjithë në mbrojtje të lirisë dhe Kushtetutës. Të gjithë në mbrojtje të vetëvendosjes dhe kolonizimit serb. Stop barbarëve! Liri popullit!".

Traktet u përfunduan shumë shpejt. Do të deshën të kenë më disa trakte për t'i shpërndarë deçanasve, por nuk kishin më...

Të lumtur për veprën atdhetare të bërë, u kthyen në shtëpi.

-O djema, a nuk duhet ta njoftojmë mësuesin se kryem detyrën?, tha Ismeti.
-Ta njoftojmë. Të shkojmë në qendër.
Në qendër, prani e egër policore. Serbët e uniformuar ishin të gjithë më fytyra të ngrysura dhe me armën në dorë. Por, edhe populli ishte i madh në numër.
Ismeti pa ish mësuesin e vet.
-Mësues, kemi kryer detyrën. Të gjithë traktet i kemi shpërndarë, tha Ismeti.
-Mirë keni bërë. Ju lumtë djema.
-Mësues, kam shkruar një fjalim të shkurtër. Dua ta lexoj para popullit.
-Ta shoh, tha mesoburri.
Dhe Ismeti hapi çantën dhe nxori një fletore. Mësuesi i bëri disa korrigjime dhe tha:
-Teksti është mjaft i mirë. Lexoje! Ta jap një altoparlant. Hajde me mua!
Dhe Ismeti shkoi me ish mësuesin e tij, deri te një tribune e improvizuar. Ngriti shkallet dhe plot me emocione filloi te lexoje:
-Shqiptarë të mbledhur këtu, në këtë shesh! Siç e dimë të gjithë, pushteti serb dëshiron që të nëpërkëmb pavarësinë e Kosovës dhe Kushtetutën e shpallur më 7 shtator dhe do të tentojë të mbjell mes nesh frikë e ankth me represion dhe dhunë. Ne nuk duhet të kemi frikë. Një populli të tërë, edhe përballë një pushtuesi aq të egër siç është ai serb,

nuk mund t'i mbyllet goja. Prandaj, populli shqiptar duhet të demonstrojë, të afirmojë të drejtat e veta dhe të mos ketë frikë. Këto janë hapat e para drejt lirisë. Sot është populli në rrugë, nesër do të jetë në male. Pushtuesi ka për të humbur, nëse tregojmë përkushtim dhe vetmohim! Liria mbrohet vetëm me gjak.
Dhe, kur tha këtë gjë, një plumb dum dum të policisë serbe e qëlloi në kokë. Ismeti ra, Ai ra, por sakrifica e tij, si djalë i përkushtuar, trim dhe atdhetar nuk u harrua dhe nuk duhet të harrohet.

* * *

Sot, ne duhet të përkujtojmë dëshmorët e oreve të para, dëshmorët e barrikadave dhe dëshmorët e maleve, por jo vetëm këtë gjë duhet ta bëjmë. Ne duhet edhe që amaneti i dëshmorëve ta çojmë deri në fund, deri në çlirimin e ribashkimin e plotë e atdheut.
Lavdi dëshmorëve të kombit!
Qoftë i lehtë dheu i Shqipërisë Etnike!

Rumani, 4 Mars 2015

**NOTË: Ngjarjet në këtë tregim janë fiktive, përveç pjesëmarrjes se Ismet Qorrajt, Sali Hadergjonajt, Agim Kuklecit dhe Mujë Mehmetajt në demonstratën e 28 marsit 1989 dhe rënies së tyre heroike.*

Autorët pjesëmarrës në Antologji:

Flori Bruqi - Në vend të parathënies.
Gentjan Banaj
Skënder Zogaj
Engjëll Koliqi
Prof. Dr. Begzad Baliu
Qazim Berisha
Aishe Qorraj
Agim H. Berisha
Agim Desku
Bilall Maliqi
Drenusha Morina
Dibran Fylli
Ermelinda Smajl Qorraj
Esat Loshaj
Ermira R. Isufi
Fjolla Qorraj
Flori Bruqi
Fran Ukcama
Farida Ramadani (Zmijani)
Fera Krasniqi

Gani Xhafolli
Isuf Grajçevci
Kumrije Qorraj-Bruqi
Linditë Ramushi Dushku
Mimoza Legisi
Migena Arllati
Mona Agrigoroaiei
Mentor Thaqi
Musa Jupolli
Mevlyde Mezini Saraçi
Nebih Bunjaku
Rajmonda Maleçka
Remzije Zekolli
Rami Kamberi
Shahbaze Vishaj-Grajçevci
Shkurta (Musa) Januzi
Teuta A. Muji
Vullnet R. Mato
Vjollca Tiku Pasku
Xheladin A. Çitaku
Xheladin Mjeku
Zef Pergega
Zeqir Fazliu
Xhevdet Qorraj
Mona Agrigoroaiei

Titulli : Mars Përflakur
Antologji poetike për dëshmorin Ismet Qorraj
Përgatiti dhe redaktoi : Flori Bruqi
Recenzent : Izet Duraku, Rexhep Shahu
Ballina & arti grafik : BoV Desing
Fotoja në ballinë : Deshmori Ismet Qorraj
© Të gjitha të drejtat janë të Axhensionit Floripres
ISBN: 978-9928-4261-8-5
Shtëpia botuese : Klubi i Poezisë, Tiranë
e-mail : klubipoezis@yahoo.com
Telefon : +355 682076965
+355682460417
Shtypshkronja : Vision Print Prishtinë

Prishtinë - Tiranë, 2015